



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**AUTORITETI I KONKURENCËS
DREJTORIA E SHËRBIMEVE MBËSHTETËSE**

**SHPALLJE PËR NJË VEND TË LIRE PUNE,
LËVIZJE PARALELE DHE PRANIM NË SHËRBIMIN CIVIL**

**“Specialist” në Drejtorinë e Integrimit dhe Komunikimit
Kategoria e pagës III-b**

Në zbatim të nenit 22 dhe të nenit 25, të ligjit 152/2013 “Për nëpunësin civil”, te ndryshuar si dhe të Kreut VIII të Vendimit nr. 243, datë 18/03/2015, të Këshillit të Ministrave, Autoriteti i Konkurrencës shpall procedurat e lëvizjes paralele dhe pranimit në shërbimin civil për pozicionin:

- Specialist në “Drejtorinë e Integrimit dhe Komunikimit”
- Kategoria e pagës III-b

Pozicioni më sipër, u ofrohet fillimisht nëpunësve civilë të së njëjtës kategori për procedurën e lëvizjes paralele!

Vetëm në rast se në përfundim të procedurës së lëvizjes paralele, rezulton se ky pozicion është ende vakant, ai është i vlefshëm për konkurimin nëpërmjet procedurës së pranimit në shërbimin civil

Për të dy procedurat (lëvizje paralele dhe pranim në shërbimin civil) aplikohet në të njëjtën kohë!

Afati për dorëzimin e dokumentave:	10 dhjetor 2018

***Afati i aplikimit dhe dorëzimit të dokumentacionit është i njëjtë për të dyja procedurat.**



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

AUTORITETI I KONKURENCËS DREJTORIA E SHËRBIMEVE MBËSHTETËSE

Përshkrimi përgjithësues i punës për pozicionin e mësipërm është:

Përgjigjet për ecurinë e procesit të integritit evropian duke bashkëpunuar dhe raportuar rregullisht sipas kërkesave me MJI, përgatit termat e referencës për aplikim dhe përthithje të fondeve të BE-së dhe organizmave të tjerë në kuadër projektsh si dhe për çdo deyrë të caktuar në kuadër të realizimit dhe bashkërendimit me institucionet e tjera në kuadër integrimi duke përthithur praktikatat më të mira Europiane.

I-Lëvizja paralele

Kanë të drejtë të aplikojnë për këtë procedurë vetëm nëpunësit civilë të së njëjtës kategori, në të gjitha insitucionet pjesë e shërbimit civil.

1.- Kushtet për lëvizjen paralele dhe kriteret e veçanta

Kandidatët duhet të plotësojnë kushtet për lëvizjen paralele si vijon:

- Të jetë nëpunës civil i konfirmuar, brenda së njëjtës kategori
- Të mos ketë masë disiplinore në fuqi (të vertetuar me një dokument nga institucioni);
- Të ketë të paktën një vlerësim pozitiv (për kandidatët e institucioneve që sapo kanë hyrë në shërbimin civil kërkohet vlerësim nga eprori direkt);

Kandidatët duhet të plotësojnë kriteret e veçanta si vijon:

- a) Të ketë përfunduar studimet e larta universitare në “Drejtësi” dhe të zotërojë diplomë “Master” në këtë fushë.
- b) Të zotërojë gjuhën angleze dhe një gjuhë e dytë e vendeve të BE përbën avantazh.
- c) Të zotërojë aftësi të punës ne grup
- d) Të ketë njohuri të gjera dhe aftësi shumë të mira në fushën e integritit, institucioneve të BE dhe organizatave ndërkombetare, bazat e diplomacisë dhe të drejtës Ndërkombëtare publike.

2.- Dokumentacioni, mënyra dhe afati i dorëzimit

Kandidatët duhet të dorëzojnë pranë njësisë së burimeve njerëzore të Autoritetit të Konkurrencës ku ndodhet pozicioni për të cilin ata dëshirojnë të aplikojnë, dokumentat si më poshtë:

a) Jetëshkrim i plotësuar në përputhje me dokumentin tip që e gjeni në linkun:

<http://dap.gov.al/vende-vakante/udhezime-dokumenta/219-udhezime-dokumenta>

b) fotokopje të diplomës;

c) fotokopje të librezës;



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

AUTORITETI I KONKURENCËS DREJTORIA E SHËRBIMEVE MBËSHTETËSE

ç) çdo dokumentacion tjetër që vërteton trajnimet, kualifikimet, arsimim shtesë, vlerësimet pozitive apo të tjera të përmendura në jetëshkrimin tuaj.

Dokumentat duhet të dorëzohen me postë apo drejtpërsëdrejti në institucion, brenda datës 10 dhjetor 2018.

3.- Rezultatet për fazën e verifikimit paraprak

Në datën **12 dhjetor 2018** njësia e menaxhimit të burimeve njerëzore të Autoritetit të Konkurrencës ku ndodhet pozicioni për të cilin ju dëshironi të aplikoni do të shpallë në portalin “Shërbimi Kombëtar i Punësimit” dhe në faqen e internetit, listën e kandidatëve që plotësojnë kushtet e lëvizjes paralele dhe kriteret e veçanta, si dhe datën, vendin dhe orën e saktë ku do të zhvillohet testimi.

Në të njëjtën datë kandidatët që nuk i plotësojnë kushtet e lëvizjes paralele dhe kriteret e veçanta do të njoftohen individualisht nga njësia e menaxhimit të burimeve njerëzore të institucionit ku ndodhet pozicioni për të cilin ju dëshironi të aplikoni, nëpërmjet adresës tuaj të e-mail, për shkaqet e moskualifikimit.

4.- Fushat e njohurive, aftësitë dhe cilësitë mbi të cilat do të zhvillohet intervista

Kandidatët do të vlerësohen në lidhje me:

- a) Njohuritë mbi ligjin nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, te ndryshuar.
- b) Njohuritë mbi ligjin nr. 9131, datë 08.09.2003 “Për rregullat e etikës në administratën publike
- c) Konkurimi do të bazohet në njohjen e ligjshmërisë në fuqi, kryesisht ligjin nr. 9121, datë 28.07.2003 ” Për Mbrojtjen e Konkurrencës” te ndryshuar dhe akteve nën ligjore në zbatim të tij, Politika Kombëtare e Konkurrencës, Kodin e Procedurave Administrative
- d) Për më shumë: www.caa.gov.al

5.- Mënyra e vlerësimit të kandidatëve

Kandidatët do të vlerësohen për jetëshkrimin, eksperiencat, trajnimet, kualifikimet e lidhura me fushën, si dhe vlerësimet pozitive. Totali i pikëve për këtë vlerësim është 40 pikë.

Kandidatët gjatë intervistës së strukturuar me gojë do të vlerësohen në lidhje me:

- Njohuritë, aftësitë, kompetencën në lidhje me përshkrimin e pozicionit të punës;
- Eksperiencën e tyre të mëparshme;
- Motivimin, aspiratat dhe pritshmëritë e tyre për karrierën.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

AUTORITETI I KONKURENCËS DREJTORIA E SHËRBIMEVE MBËSHTETËSE

Totali i pikëve në përfundim të intervistës së strukturuar me gojë është 60 pikë.

Më shumë detaje në lidhje me vlerësimin me pikë, metodologjinë e shpërndarjes së pikëve, mënyrën e llogaritjes së rezultatit përfundimtar i gjeni në Udhëzimin nr. 2, datë 27.03.2015 të Departamentit të Administratës Publike “www.dap.gov.al”

<http://dap.gov.al/vende-vakante/udhezime-dokumenta>

6.- Data e daljes së rezultateve të konkurimit dhe mënyra e komunikimit

Në përfundim të vlerësimit të kandidatëve, Autoriteti i Konkurrencës do të shpallë fituesin në portalin “Shërbimi Kombëtar i Punësimit” dhe në faqen zyrtare të AK. Të gjithë kandidatët pjesëmarrës në këtë procedurë do të njoftohen në mënyrë elektronike për datën e saktë të shpalljes së fituesit.

II- Pranim në shërbimin civil

Vetëm në rast se pozicioni i renditur në fillim të kësaj shpalljeje, në përfundim të procedurës së lëvizjes paralele, rezulton se është ende vakant, ai është i vlefshëm për konkurimin nëpërmjet procedurës së pranimit në shërbimin civil.

Për këtë procedurë kanë të drejtë të aplikojnë të gjithë kandidatët që plotësojnë kërkesat e përgjithshme në përputhje me nenin 22 të ligjit nr 152/2013 “Për nëpunësit civil”, I ndryshuar.

Kushtet që duhet të plotësojë kandidati në procedurën e pranimit në shërbimin civil

Kandidatët duhet të plotësojnë kriteret e veçanta si vijon:

- Të ketë përfunduar studimet e larta universitare në “Drejtësi” dhe të zotërojë diplomë “Master” në këtë fushë
- Të zotërojë gjuhën angleze dhe një gjuhë e dytë e vendeve të BE përbën avantazh.
- Të zotërojë aftësi të punës në grup
- Të ketë njohuri të gjera dhe aftësi shumë të mira në fushën e integritit, institucioneve të BE dhe organizatave ndërkombetare, bazat e diplomacisë dhe të drejtës Ndërkombëtare publike.

Kandidatët që aplikojnë duhet të dorëzojnë dokumentat si më poshtë:

a) Jetëshkrim i plotësuar në përputhje me dokumentin tip që e gjeni në linkun:



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**AUTORITETI I KONKURRENCËS
DREJTORIA E SHËRBIMEVE MBËSHTETËSE**

<http://dap.gov.al/vende-vakante/udhezime-dokumenta/219-udhezime-dokumenta>

b) fotokopje të diplomës dhe listës së notave;

c) fotokopje të librezës së punës;

ç) çdo dokumentacion tjetër që vërteton trajnimet, kualifikimet, arsimim shtesë, vlerësimet pozitive apo të tjera të përmendura në jetëshkrimin tuaj.

d) Vertetimi gjendjes gjyqesore

dh) Numer kontakti dhe adrese vendbanimi

Kandidatët duhet të dorëzojnë të gjitha dokumentat e cituara më sipër me poste ose dorazi, *brenda datës 10 dhjetor 2018* në Autoritetin e Konkurrencës me adrese: Rruga “Sami Frasheri”, kati IV. Nr.4.

Të gjithë kandidatët që aplikojnë për procedurën e pranimit në shërbimin civil, do të marrin informacion në faqen e Autoritetit të Konkurrencës, për fazat e mëtejshme të kesaj procedure:

- për datën e daljes së rezultateve të verifikimit paraprak,
- datën, vendin dhe orën ku do të zhvillohet konkurimi;
- mënyrën e vlerësimit të kandidatëve.

Për të marrë këtë informacion, kandidatët duhet të vizitojnë në mënyrë të vazhdueshme faqen e Autoritetit të Konkurrencës duke filluar nga data 12 dhjetor 2018.